



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100088/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandim për zbatimin e parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret forcë fizike për të kontrolluar sjelljen e protestuesve (disa raste të ndodhura gjatë protestave të mbajtura në Tiranë, në muajin dhjetor 2020)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT
Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË TIRANË

Për dijëni: **MINISTRISË SË BRENDSHME**
Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Në datën 8 dhjetor 2020 u raportua për një ngjarje të rëndë të ndodhur në qytetin e Tiranës. Shtetasi Klodian Rasha u qëllua me armë zjarri nga një punonjës i Policisë së Shtetit dhe për pasojë gjeti vdekjen. Punonjësi i policisë, i dyshuar si autor i veprës penale është arrestuar nga organi i prokurorisë. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, çështja aktualisht është duke u gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Vrasja e të ndjerit Klodian Rasha shkaktoi reagimin e qytetarëve në mbarë vendin, të cilët kërkuan zbardhjen sa më parë të ngjarjes dhe vendosjen para drejtësisë të personit përgjegjës.

Në ditët që pasuan ngjarjen u mbajtën disa protesta, në qytete të ndryshme të vendit, ku pjesëmarrës ishin kryesisht të rinj, mes tyre edhe persona jo madhorë, nën moshën 18 vjeç. Në Tiranë, protestat ishin të shpërndara në disa zona të qytetit, në të cilat janë shënuar edhe raste ku disa pjesëmarrës kanë kryer veprime të dhunshme ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, duke i goditur ata me sende të forta, duke dëmtuar disa godina të institucioneve shtetërore dhe objekte publike. Për këto akte institucioni i Avokatit të Popullit ka mbajtur qëndrim publik, si të papranueshme dhe të pajustificuara pavarësisht indinjatës së qytetarëve për shkak të ngjarjes së ndodhur. Në të gjitha rastet Avokati i Popullit ka bërë thirrje për ushtrimin në mënyrë paqësore të së drejtës së protestës duke kërkuar vetëpërmbytje nga të gjitha palët.

Policia e Shtetit ka ndërhyrë për të shpërndarë protestat duke përdorur forcën fizike, gaz lotsjellës dhe ujë me presion. Gjatë protestave apo fill pas tyre janë shoqëruar në Komisaritet e Policisë Tiranë një numër jo i vogël protestuesish.

Institucioni i Avokatit të Popullit në vijimësi ka monitoruar protestat nëpërmjet pamjeve të shfaqura në media dhe grupeve të punonjësve që ndodheshin në terren. Gjithashtu pas përfundimit të protestave janë kryer vizita dhe inspektime në ambientet e strukturave të Policisë Vendore në Tiranë.

Në median vizive dhe atë elektronike është raportuar për disa raste kur punonjës të Policisë së Shtetit kanë përdorur forcë të pajustificuar ndaj disa shtetasve. Nga ana jonë janë administruar pamjet filmike, të cilat janë këqyrur me vëmendje për t'u shprehur lidhur me rregullsinë e veprimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Përdorimi i forcës është i pashmangshëm në situatë/kushte të caktuara gjatë kryerjes së veprimtarisë apo detyrave nga strukturat e Policisë së Shtetit. Punonjësi i policisë mund të ndodhet në rrethana të tilla që rrezikojnë jetën e tij apo të një personi tjetër si dhe mund të ndeshet me rezistencë të dhunshme ose pasive nga shtetas të ndryshëm. Kur punonjësi i policisë vendos të përdorë forcën duhet të ketë parasysh disa faktorë, sikurse janë:

- domosdoshmëria e përdorimit të forcës;
- shkalla e kërcënimit;
- masa e forcës;
- kohëzgjatja e saj.

Nëse është e domosdoshme të vihet nën kontroll sjellja e një individi, intensiteti i forcës së ushtruar ndaj tij nuk duhet të jetë më shumë nga sa është e nevojshme dhe të minimizohen dëmet që mund t'i shkaktohen. Parimi i proporcionalitetit dhe i përshkallëzimit të masave shtrënguese zbatohet si kur vendoset të përdoret forcë fizike ashtu edhe kur përdoren mjete të veçanta, siç është bombula sprajt (me piper). Punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri¹.

Për të analizuar nëse veprimet e punonjësve të policisë janë kryer ose jo në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë, po parashtröjmë rregullat që përcakton legjislacioni për përdorimin e forcës.

Në nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar parashikohen masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike sipas të cilave, kur sjellja e një personi cenon rendin dhe sigurinë publike, punonjësi i policisë, në zbatim të përgjegjësive të tij dhe në përputhje me ligjin, merr masa për shmangien e rrezikut për shtetasin dhe veten si dhe vlerëson nëse është e nevojshme marrja e masave shtesë ose dhënia e ndihmës dhe njofton menjëherë autoritetet përgjegjëse administrative.

Po ashtu, përcaktohet se “*masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë, të drejtat dhe interesat që vihen në rrezik dhe/ose cenohen, si dhe nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur*”. Vetëm “*nëse kjo masë është e paefektshme, atëherë mund të zgjidhet një masë tjetër proporcionale me ndikim më të madh. Zbatimi i mëtejshëm i çdo mase të ndërmarrë ndërpritet menjëherë kur shkakun e saj nuk ekziston më. Ndërsa, zbatimi i masës së menjëhershme merret vetëm nëse duhet mënjanuar një rrezik real dhe i çastit për rendin dhe sigurinë publike, i cili nuk mund të shmanget me anë të mjeteve të tjera duke njoftuar menjëherë personin ndaj të cilit ajo ndërmerret*”.

Sa i përket përdorimit të forcës, i referohemi nenit 133 të ligjit të sipërpërmendur sipas të cilit:

1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.
2. Punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

¹ Neni 133/3 i Ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar.

3. Punonjësi i policisë për zgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.

4. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.

5. Punonjësi i policisë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.

6. Grupe personash paralajmërohen sa më shpejt të jetë e mundur se do të përdoret forcë ose forma e forcës së përdorur do të ndryshohet, në mënyrë që pjesëmarrësit të lejohen të largohen.

Ndërsa, në VKM Nr.750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, përkatësisht nenet 110 dhe 211, përcaktohet si më poshtë:

Neni 110

Proporcionaliteti i përdorimit të forcës

1. Punonjësi i Policisë përdor forcën vetëm kur është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme dhe vetëm në masën që kërkohet për të arritur një synim të ligjshëm.

2. Punonjësi i Policisë, në çdo rast e përdor forcën pa cenuar thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe përdor gjithmonë mjete të përshtatshme në proporcion me rrezikun dhe qëllimet që synohen të arrihen.

3. Punonjësi i Policisë është përgjegjës individualisht për ushtrimin e forcës dhe jep llogari para ligjit.

Neni 211

Përdorimi i paligjshëm dhe i paarsyeshëm i forcës

Punonjësi është përgjegjës për përdorim të paligjshëm dhe të paarsyeshëm të forcës, nëse:

1. përdor forcën në intensitet dhe kohë, mbi masën që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim dhe të ligjshëm të Policisë;
2. përdor forcën, e cila nuk është proporcionale me shkallën e kërcënimit dhe nuk është e balancuar me nevojën për të zvogëluar shkaktimin e viktimave civile, dëmet e pasurisë, si dhe ambientin natyror;
3. përdor mjetet për përdorimin e forcës në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore të Policisë.

Ndërsa, përsa i takon përdorimit të sprajtit nga punonjësit e policisë parashikohen udhëzime të veçanta në Urdhrin nr.92, datë 06.02.2015 “Përdorimi i lëndëve lakrimogjene” të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Sipas këtyre udhëzimeve:

1. Punonjësi i policisë sipas kompletimit organik gjatë kryerjes së shërbimit mban me vete bombolën e sprajtit (me piper ose gaz) në anën e krahut dominant me qëllim që në rast se sulmohet nga një person apo grup personash të dhunshëm ta nxjerrë e ta përdorë lehtësisht.
2. Punonjësi i policisë mund të përdorë bombolën (sprajtin) personal (armatim e pajisje në organikë) për vetëmbrojtje, pasi ka ezauruar më parë mjetet që përdoren sipas procedurës në rastet e përdorimit të forcës.
3. Ndalohet kategorikisht përdorimi i bombolave me gaz lakrimogjen në kundërshtim me rregullat e pa shkaqe të përligjura, për lojë në ambiente të mbyllura (makinë me kolegët, në dhomat e shoqërimit dhe vende të ngjashme të kësaj natyre).
4. Në rast sulmi të dhunshëm e të befasishëm ndaj tij punonjësi i policisë e nxjerr shpejt dhe e drejton sprajtin në fytyrën e sulmuesit në distancë 30-60 cm me qëllim që të frenojë sulmin e të mposhtë rezistencën e personit që sulmon.

Rastet që do rendisim dhe analizojmë më poshtë janë administruar nga grupet e institucionit të Avokatit të Popullit nga monitorimet e mediave² që kanë pasqyruar

² Për më tepër, si burim informacioni mund të shihen faqet web ku gjenden pamjet filmike (videot) që janë vlerësuar nga ana jonë se ka patur tejkalim të forcës nga punonjës të Policisë së Shtetit, si më poshtë:
<https://www.syri.net/kronike/389610/video-i-riu-qe-u-dhunua-barbarisht-kam-qepje-ne-vesh-dhe-koke/>
<https://www.balkanweb.com/tensione-ne-proteste-i-riu-qellohet-me-grushte-nga-efektivet-disa-te-shoqeruar/>
<https://dosja.al/pamje-te-frikshme-civilet-terheqin-zvarre-protestuesit-i-fusin-brenda-ministrise-se-brendshme-cfare-u-be-me-to/>
https://www.instagram.com/p/CItU6yOh5Hh/?utm_source=ig_embed&utm_campaign=loading

zhvillimin e protestave të organizuara në muajin Dhjetor 2020. Për këto raste, çmujmë se ka patur përdorim të paarsyeshëm të forcës nga ana e disa punonjësve të policisë. (Bashkëlidhur këtij rekomandimi do të gjeni të hedhura në CD pamjet e përshkruara si më poshtë.)

Episodi 1. Punonjës të Policisë së Shtetit, me veshje dhe mjete mbrojtëse (helmetë dhe mburojë plastike), shpërndajnë disa qytetarë që ndodhen në rrugën ndërmjet Kryeministrit dhe Kuvendit duke u bërë thirrje të largohen. Qytetarët janë të pakët në numër dhe situata paraqitet e qetë. Dy djem, qëndrojnë në vend mbi trotuar dhe u drejtohen punonjësve të policisë me fjalët “do ikim”. Një punonjës policie i shtyn me duar për t’i larguar. Djali i veshur me të zeza, vendos një dorë në krahun e punonjësit të policisë, në dukje për mos t’u shtyrë. Punonjësi i largon dorën dhe djali e kap nga veshja. Në këtë çast, punonjësi në fjalë e godet djalin dy herë me shkop gome në fytyrë dhe një koleg i tij i hedh sprajt me bombul po në fytyrë. Me shkop gome goditet tre herë edhe shoku i djalit me të zeza që përpiqet ta mbrojë duke vendosur krahun para shkopit të gomës. Djali me të zeza tenton të godasë me grusht punonjësin, por nuk arrin ta realizojë. Ai rrethohet fillimisht nga katër punonjës, dy prej të cilëve e kufizojnë fizikisht. Djali goditet me shkop gome pas koke dhe spërkatet me sprajt megjithëse nuk kryen veprime kundra punonjësve dhe përpiqet të mbrohet. Me sprajt spërkatet edhe shoku i tij, i cili duket se u bën thirrje i shqetësuar punonjësve. Djali i veshur me të zeza shoqërohet nga dy punonjës në drejtim të një automjeti të policisë. Vërehet se ai është i gjakosur pas kokës.

Pamjet e përshkruara më lart tregojnë se situata ka qenë e qetë, numri i qytetarëve që ndodheshin para Kryeministrit i pakët. Ata nuk kryejnë asnjë veprim të dhunshëm. Punonjësit e policisë kanë veshje dhe mjete mbrojtëse. Rradhët e tyre janë të ngjeshura. Përveç faktit që djali i veshur me të zeza mban qëndrim pasiv ndaj kërkesës së punonjësve të policisë për t’u larguar dhe tenton të godasë me grusht njërin prej tyre, duke qenë nën efektin e sprajtit si dhe në gjaknxehtësi si kundërpërgjigje e goditjes me shkop gome, nuk paraqitet asnjë rrethanë që të përbëjë rrezik për jetën apo shëndetin e punonjësve të policisë. Këta të fundit janë të mbrojtur nga helmata dhe mburoja plastike dhe të shumtë në numër. Goditja me shkop gome dhe spërkatja me sprajt ndaj dy djemve duket të jetë një veprim ndëshkues i punonjësve të policisë, dhe jo një veprim i domosdoshëm për t’iu përgjigjur një rreziku të çastit. Në vlerësimin tonë, veprimet e punonjësve të policisë përbëjnë përdorim të paarsyeshëm të forcës si në intesitet ashtu edhe në kohëzgjatje. Edhe mjetet e përdorura për të frenuar rezistencën e personit janë jo në proporcion me rrethanat.

Episodi 2. Disa punonjës të policisë të veshur civilë kanë ndaluar tre djem duke i mbajtur nga krahët dhe po lëvizin në drejtim të rrugicës që kalon pas godinës së Bashkisë Tiranë, në afërsi të Sahatit. Dallohet qartë se djemtë e ndaluar nuk bëjnë rezistencë dhe ndjekin ritmin e lëvizjes së punonjësve të veshur civilë, të cilët i qëndrojnë në krah dhe i ndjekin nga pas. Një nga punonjësit godet me grusht në stomak një nga djemtë, në lëvizje e sipër, megjithëse ai nuk kryen asnjë veprim që përbën rrezik. Në vlerësimin tonë, forca e ushtruar në këtë rast është e paligjshme, pasi është përdorur si ndëshkim dhe jo për të arritur një objektiv legjitim.

Episodi 3. Përgjatë rrugës automobilistike që kalon në krah të godinës së Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe godinës së Bashkisë Tiranë, në afërsi të BunkArt2, janë vendosur kangjella, pas të cilave qëndrojnë gardh punonjës të Policisë së Shtetit të veshur me uniformë. Punonjës të veshur civilë, vijnë nga drejtimi i qendrës duke marrë me forcë tre djem, të cilët i tërheqin përtej kangjellave dhe i qëllojnë me shpulla dhe shkelma nga pas. Punonjësit e policisë janë të shumtë në numër dhe nuk duket të ndodhen në një situatë që të përbëjë rrezik për ta. Tre djemtë e marrë me force në këtë moment nuk kryejnë asnjë veprim të dhunshëm ndaj punonjësve të policisë. Edhe në këtë rast, forca e ushtruar është e paligjshme, pasi është përdorur si ndëshkim dhe jo për të arritur një objektiv legjitim.

Episodi 4. Në shesh parkingun e ndodhur në Rrugën “Moskat”, rrugë kalimi nga Stadiumi “Selman Stërmasi” për te ish-Blloku, është filmuar një punonjës policie i veshur me uniformë, i cili me sa kuptohet ka ndjekur një nga djemtë protestues, e ka kapur atë nga veshja dhe nuk e lejon të largohet. Ndërkohë për gjatë rrugës vazhdon lëvizja normale e makinave. Djali, përveç përpjekjes për t’u çliruar nga mbërthimi i punonjësit të policisë nuk kryen asnjë veprim që të përbëjë rrezik për punonjësin apo për persona të tjerë, megjithatë ai goditet disa herë me shkop gome në gjymtyrët e poshtme. Mundet që ai të jetë përfshirë më parë në sjellje që kanë cënuar rendin dhe sigurinë dhe punonjësi i policisë e ka ndjekur për t’a shoqëruar në ambientet e strukturave të policisë për veprime të mëtejshme. Por në çastin e ndalimit, djali nuk përbën kërcënim dhe goditja me shkop gome është një masë jo proporcionale me synimin që kërkon të arrijë punonjësi përkatës i policisë.

Sjellim në vëmendjen Tuaj, se edhe më parë kemi referuar për raste kur punonjës të Policisë së Shtetit kanë ushtruar forcë të paligjshme dhe jo proporcionale me rrethanat, veçanërisht gjatë dhe pas protestave të mbajtura në vend.

Protestat ku marrin pjesë një numër i madh personash, krijojnë situata nga më të vështirat për t'u kontrolluar nga Policia e Shtetit, veçanërisht kur protestuesit janë të shpërndarë në pika të ndryshme të qytetit, sikurse ndodhi në muajin dhjetor 2020 në qytetin e Tiranës. Policia e Shtetit ka një detyrë jo të lehtë për të ruajtur ekuilibrin ndërmjet garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të protestuesve nga njëra anë dhe sigurisë së punonjësve të angazhuar në terren dhe shtetasve të tjerë nga ana tjetër. Situata është dinamike, turma e protestuesve është e paparashikueshme dhe ndonjëherë ka edhe shtetas që mund të kryejnë veprime të dhunshme. Në disa raste forca e tepruar mund të përshkallëzojë situatën për shkak të irritimit, gjithashtu, edhe forca e kursyer.

Duke vlerësuar rolin e domosdoshëm të Policisë së Shtetit për mbarëvajtjen e rendit dhe të vetëdijshëm për rrezikun që i kanoset punonjësve të policisë gjatë punës së tyre, tërheqim vëmendjen në faktin se rastet ku qartësisht ka patur tejkalim të forcës ose përdorim të paligjshëm të saj kanë kaluar në heshtje dhe nuk janë hetuar nga mekanizmat e jashtëm të Policisë së Shtetit që mbikëqyrin veprimtarinë e saj. Kjo kuptohet edhe nga përgjigjet që kemi marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit³ dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë⁴ lidhur me gjetjet tona të paraqitura në raportin që ka të bëjë me veprimet/mosveprimet e kundërligjshme të strukturave të Policisë së Shtetit gjatë dhe pas prishjes së godinës së Teatrit Kombëtar.

Ky qëndrim ka ndikim negativ në perceptimin që krijon publiku për Policinë e Shtetit dhe misionin e saj. Ndër detyrat më të rëndësishme të kësaj strukture, është dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj dhe shërbimet policore, duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogari-dhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Punonjësit e policisë gjithashtu, duhet të trajnohen në vijimësi, që të mos përdorin forcë më shumë sesa është nevojshme, kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe nuk kryen veprime aktive apo rezistencë e mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë justifikim, për goditjen e tij apo ushtrim force në forma të tjera.

Legjislacioni parashikon mbikëqyrjen e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në nivel qëndror nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e

³ Shkresa Nr.7299/1 Prot., datë 28.12.2020.

⁴ Shkresa Nr.8628/7 Prot., datë 18.12.2020.

Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Këto struktura vihen në lëvizje nga shtetasit, punonjësit e policisë dhe me nismën e vet për rastet që bëhen publike.

Vlerësojmë se, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave duhet të ushtrojë detyrën me përgjegjshmëri dhe në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij për: parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, si dhe të shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj; inspektimin dhe trajtimin e ankesave ndaj punonjësve të strukturave për mospërbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit; ruajtjen e integritetit të punonjësve të strukturave etj.

Ne çojmë se kryerja e një hetimi administrativ nga ana e këtij organi mbi këto episode, identifikimi i punonjësve përgjegjës të policisë që kanë kryer shkeljen, sqarimi i rrethanave të ndodhjes së ngjarjes dhe arritja në përfundime konkrete nga hetimi, është tregues i vendosmërisë së autoriteteve shtetërore për të forcuar përgjegjshmërinë e punonjësve të policisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si dhe për të rritur performancën e këtij organi në publik.

Në Raportin e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT) të Këshillit të Evropës, i bërë publik në datën 17.09.2019, është rekomanduar që autoritetet shqiptare duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjësit e policisë. Në veçanti, duhet t'u silltet në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtimit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat.

Për më tepër, në pjesën e raportit që ka të bëjë me Policinë e Shtetit⁵, shkronja “A”, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar. Disa nga rekomandimet që kanë të bëjnë me parandalimin e keqtrajtimit, përdorimin e forcës dhe hetimin e ankesave ndaj Policisë së Shtetit, janë si më poshtë:

“A. Ndalimi nga Policia

2. Keqtrajtimi

⁵ Për më shumë shih:

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

14. Është thelbësore të sigurohet që punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjës të policisë. Në veçanti, duhet t'u silltet në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtimit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohet në përputhje me rrethanat.

Oficerët e policisë gjithashtu duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është nevojshme kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme.

15. Përbërës thelbësor i çdo strategjie për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një të dhëne për keqtrajtim, personat e cënuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Hetime të tilla duhet të përputhen ndër të tjera me kriterin e shpejtësisë, tërësisë dhe gjithëpërfshirjes.

Ju sjellim në vëmendje se, ankesa që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës nga Policia e Shtetit gjatë protestave kanë qenë objekt shqyrtimi edhe në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo Gjykatë ka çmuar se ka patur shkelje të nenit 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut kur ka vënë re se lëndimet e ankuesit nuk justifikoheshin me rrethanat dhe tejkalimi i forcës për personin konkret kishte ndodhur vetëm për faktin se duhej të shpërndahej protesta. Gjithashtu Gjykata ka tërhequr vëmendjen ndaj autoriteteve shtetërore se, nuk kishte patur përpjekje serioze për të përcaktuar rrethanat e përdorimit të forcës, shkakun e lëndimeve të ankuesit si dhe punonjësit e përfshirë në ngjarje⁶.

Gjithashtu GJEDNJ në praktikën e saj ka konsideruar se njoftimi, dhe madje procedurat e autorizimit, për një ngjarje publike normalisht nuk shkelin mbi thelbin e së drejtës në

⁶ Shih vendimet *Gazioglu and Others v. Turkey*, 17 maj 2011, kërkesa nr. 29835/05 dhe *Suleyman Çelebi and Others v. Turkey*, 24 maj 2016, kërkesa nr. 37273/10.

bazë të nenit 11 të Konventës për sa kohë që qëllimi i procedurës është që të lejojë autoritetet të marrin masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të garantuar zhvillimin normal të çdo tubimi, mbledhje apo grumbullimeve të tjera⁷.

Po ashtu, liria për të marrë pjesë në një tubim paqësor është e një rëndësie të tillë që një person nuk mund të jetë subjekt i sanksionit - madje edhe me një dënim të ulët në shkallën e dënimeve administrative - për pjesëmarrje në një demonstratë, për aq kohë sa ai person nuk ka kryer vetë ndonjë veprim të gabuar në një rast të tillë.⁸

Qëndrim publik lidhur me përshkallëzimin e situatës në dhjetor 2020, ka mbajtur edhe Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Znj. Dunja Mijatovic, e cila ndër të tjera është shprehur se: “Autoritetet shqiptare duhet të tregojnë përmbajtje në menaxhimin policor të demonstratave dhe të sigurojnë hetime të hollësishme, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e përdorimit të tepruar të forcës. Ndërsa e drejta për mbledhje paqësore mund të kufizohet për të mbrojtur shëndetin publik, autoritetet duhet të mbështesin parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në të gjitha rrethanat. Policia gjithashtu duhet të bëjë dallimin midis individëve të përfshirë në dhunë dhe atyre që demonstrojnë në mënyrë paqësore dhe të përmbahen nga përdorimi i rëndë ose pa kriter i forcës.”⁹

Gjithashtu, Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut ka ritheksuar që policimi i demonstratave duhet të bazohet në komunikim dhe bashkëpunim me organizatorët dhe pjesëmarrësit në demonstrata dhe duhet të synojë në uljen e përshkallëzimit të tensioneve. Sipas znj.Mijatovic, “është thelbësore të sigurohet që oficerët e policisë që veprojnë në kontekstin e demonstratave të marrin trajnim të specializuar në menaxhimin e negociuar të asambleve dhe përdorimin proporcional të forcës.”

Vlerësojmë se sjellja korrekte, zbatimi rigoroz i dispozitave ligjore, etika policore dhe respektimi i standardeve profesionale nga punonjësit e Policisë së Shtetit shërbejnë për të siguruar qytetarin se dhënia e shërbimeve të policisë është e cilësisë më të lartë, ndaj ky

⁷ Shih, *Sergey Kuznetsov kundër Ruisë*, nr. 10877/04, § 45, 23 tetor 2008.

⁸ Shih, *Ezelin k. Francës*, 26 prill 1991 § 35, *Seria A nr. 202*; dhe *Barraco k. Francës*, nr. 31684/05, § 41, 5 March 2009.

⁹ Për më tepër, mund të shihet Deklarata e plotë e Komisionerit e datës 16.12.2020:

<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/albanian-authorities-must-prevent-further-police-violence-and-uphold-the-right-to-freedom-of-peaceful-assembly>

rekomandim duhet të bëhet objekt i analizës së punës me strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit.

Institucioni i Avokatit të Popullit po zhvillon edhe një hetim mbi procedurat e shoqërimit të shtetasve në ambientet e strukturave të Policisë Vendore në Tiranë, gjetjet e të cilit do Ju bëhen me dijeni në vijim.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*".

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për analizimin e thellë e të gjithanshëm, me objektivitet dhe profesionalizëm të veprimeve të kryera nga disa punonjës të policisë ndaj disa shtetasve pjesëmarrës në protestat e dhjetorit 2020, pas vrasjes së të ndjerit Klodian Rasha nga një punonjës i Policisë së Shtetit.
2. Fillimin e ecurisë disiplinore, identifikimin e punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore ndaj qytetarëve protestues, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe dhënien e masave disiplinore ndaj tyre.
3. Marrjen e masave nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave për kryerjen e veprimeve të nevojshme brenda afateve të arsyeshme për hetimin e shkeljeve ligjore të kryera nga disa punonjës të policisë ndaj disa shtetasve pjesëmarrës në protestat e dhjetorit 2020.
4. Marrjen e masave të nevojshme organizative nga strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit për të bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve, për mënyrën dhe masën e përdorimit të forcës, si dhe për sjelljen me etikë dhe korrektesë me qytetarët.

5. Përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të përdorimit të paarsyeshëm të forcës dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, ndaj shtetasve gjatë zhvillimit të tubimeve si dhe gjatë kapjes e shoqërimit të tyre në ambientet e strukturave të policisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca